

Emri i Lëndës : Metodatat e Avancuara Kërkimore I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 401	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Edona Llukacaj, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Metodat e Avancuara Kërkimore I është një lëndë që u ofron studentëve aftësitë dhe njohuritë themelore të nevojshme për të kryer kërkim në shkencat shoqërore. Lënda është dizajnuar për t'i prezantuar studentët me logjikën e metodave të kërkimit në shkencat shoqërore dhe t'i përgatisë ata për të shkruar punët e tyre kërkimore. Lënda fokusohet në konceptimin dhe procesin e kërkimit, nga identifikimi dhe gjenerimi i ideve kërkimore, tek formulimi i qëllimit dhe objektivave si dhe tek zhvillimi i pyetjeve kërkimore, rishikimi i literaturës, mbledhja e të dhënave, analiza e përmbajtjes, shkrimi i një punimi dhe shpërndarja e rezultateve. Lënda, gjithashtu, fokusohet mbi metodologjinë e hulumtimit, në natyrën e kërkimit cilësor dhe sasior, si dhe filozofitë që qëndrojnë në themel të tyre dhe tregon se si ato mund të jenë plotësuese të njëra-tjetrës në prodhimin e njohurive. Metodatat e Avancuara Kërkimore I do të hedh dritë edhe mbi çështjet etike të kërkimit shkencor, por edhe mbi domosdoshmërinë dhe mnëyrat për t'i shmangur ato.					
Objektivat		Kursi është strukturuar në mënyrë që studentët: - Të kuptojnë natyrën e kërkimit, metodat e kërkimit, hapat dhe proceset e kërkimit dhe të identifikojë parimet, termat, llojet dhe konceptet e kërkimit - Të fitojnë përvojë në hartimin e projekteve të qenësishme kërkimore në fushat e shkencave sociale - Të zhvillojnë aftësi praktike në mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave - Të marrin parasysh etikën që lidhet me implementimin e kërkimit shkencor					
Konceptet Kryesore		Metodat e Kërkimit; Rishikim Literature; Metodologji; Përpunimi dhe Analiza e të dhënave; qasja cilësore/ sasiore dhe e përzier; Plagjiatura					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje Ç'është kërkimi shkencor? Elementet e kërkimit shkencor dhe cilësia në kërkim shkencor. Prezantim i përgjithshëm i kërkimit shkencor, rëndësia e tij si pjesë integrale e përgatitjes së punimeve shkencore, punimi i diplomës dhe analiza e të dhënave. "Introduction to research methods", (Pajo, 2022, fq 1-15). (Daymon and Holloway- Qualitative, 2010, f.3-18)						
2	Dijet, teoritë paradigmata dhe këndvështrimet. Natyra e subjektit të kërkimit shkencor në shkencat sociale. Përshkrim historik i zhvillimit shkencor dhe shpjegimi i koncepteve bazë të termave kryesore që hasen në këtë lëmë. Teoritë kryesore, pikëpamjet filozofike dhe evolimi i tyre "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 1-27						
3	Natyra e të dhënave. Karakteristikat e të dhënave. Përdorimi i të dhënave si përfaqësim i realitetit shoqëror. Shpjegimi i natyrës së të dhënave dhe shpjegimi i tre koncepteve bazë, të dhëna cilësore, sasiore dhe mikse. Shembuj konkret i përdorimit të tyre në punime specifike. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 10-17						
4	Pyetjet e kërkimit shkencor, hipotezat, përkufizimet operative të kërkimit shkencor. Në këtë leksion do të shpjegohet procesi i përzgjedhjes së një teme kërkimore, llojet e variablave, llojet e hipotezave si dhe vizualizimi i një pyetje kërkimore. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 27-50						

5	Planifikimi i një projekti kërkimi shkencor. Përkufizimi, aspekte praktike. Studentët do të përpqen të realizojnë pjesën e parë të një projekt propozimi bazuar nga shpjegimi i leksioneve të deritanishme. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 1-50
6	Vlerësimi kritik i literaturës. Kërkimi i literaturës. Aspekte praktike të shqyrtimit të literaturës. Procesi i shqyrtimit të literaturës. Rëndësia e rishikimit të literaturës si pjesë bazë e punimit shkencor. Përse është i rëndësishëm rishikimi i literatures dhe si ndihmon kërkuesin për t'u përfshirë më së miri në kërkimin shkencor dhe për të formuar një bazë të punimit të tij. Formate të rishikimit të literaturës. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 53-77. Christine Daymon and Immy Holloway- Qualitative Research Methods in Public Relations and Marketing Communications, Routledge, New York, 2010, f.39-55
7	Modelet e kërkimit të avancuar. Modeli cilësor dhe modeli sasior. Niveli dhe njësia e kërkimit shkencor. Strategjitë e kërkimit shkencor. Do të shpjegohen llojet dhe modelet e hulumtimit duke u bazuar në punime konkrete të secilit lloj. Si duhet të përgatitemi për secilin nga formatet e hulumtimit dhe cilat janë karakteristikat e secilit nga modelet. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 87-112
8	Provimi Gjysmëfinal
9	Mbledhja e të dhënave. Pyetësorët, intervistat gjysëm të strukturuar. Si realizohet procesi i mbledhjes së të dhënave, si duhet të formulohen pyetjet dhe si realizohet përgatitja paraprake përpara procesin të intervistimit. Transkriptimi dhe zbardhja e intervistave. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 251-273
10	Grupet e fokusit. Vrojtimi. Burimet dytësore të të dhënave. Shpjegim i detajuar i burimeve dytësore dhe integritet të tyre së bashku me të dhënat primare gjatë procesit të kërkimit shkencor. Roli i tyre në këtë proces dhe justifikimi i përdorimit të tyre gjatë përshkrimit të metodologjisë. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 179-191 Christine Daymon and Immy Holloway- Qualitative Research Methods in Public Relations and Marketing Communications, Routledge, New York, 2010, f241-258
11	Analiza e të dhënave. Tiparet e analizës. Analiza statistikore. Llojet e analizës së të dhënave dhe shembuj konkret të realizuar nga punime të ndryshme akademike. Shpjegim i analizës statistikore dhe rëndësisë së saj si pjesë e punimit dhe gjetjes së rezultateve. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 87-100
12	Analiza tematike. Puna me të dhëna cilësore. Analiza e rrëfimeve. Analiza e ligjëritimit. Analiza e përmbajtjes. Karakteristikat e të dhënave cilësore dhe ndryshimi i tyre nga të shënat sasore. Elementet bazë që duhet të merren parasysh për realizimin e këtij procesi dhe të vecantat krahasuar me të dhënat sasore. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 281-292
13	Planifikimi dhe struktura e shkrimit akademik. Mënyra e të shkruarit Përmbledhje e koncepteve bazike në shkrimin akademik, fjalitë temë, fjalitë mbështetëse dhe fjalitë përmbyllëse. Vështrimi përgjithshëm i sistemit të referencave. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 311-317
14	Hartimi i variantit përfundimtar të punimit Shpjegim teorik i përfundimit të diplomës ose shkrimit akademik dhe mbyllja e procesit në fund. Dorëzim i projekt propozimit të realizuar sipas fazave përgjatë zhvillimit të lëndës. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 301 - 305
15	Sistemi i referencave. Plagjiatura. Si të shkruajmë referencat në pozicione të ndryshme në tekst. Llojet e referencave dhe vendosja e tyre si pjesë e bibliografisë në fund të punimit. Modelet e referencave dhe praktikim i referencave në formatin Word. "Introduction to research methods", Bora Pajo, Sage 2022, fq 301-317
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Bora Pajo, Introduction to research methods: AA Hands-on Approach (2nd Ed.) , Sage 2022. • E. Scharrer & S. Ramasubramanian, Quantitative Research Methods in Communication, Routledge 2021
Referenca të tjera	• Nazmi Xhomara, Metodatat e Avancuara të Kërkimit Shkencor, Fast Print, Tirane, 2019. • Christine Daymon ve Immy Holloway (2004) Qualitative Research Methods in Public Relations and Marketing Communications, Routledge, New York • Nicholas Walliman, Research Methods; the Basics, Routledge, Newyork, 2011
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët vlerësojnë se në çfarë konsiston kërkimi shkencor në fushën e shkencave sociale dhe si bëhet ai
2	Studentët kuptojnë konceptet, gjuhën, zbatimin e metodave të kërkimit dhe rëndësinë e tyre
3	Studentët zhvillojnë dhe artikulojnë pyetje kërkimore, hipoteza dhe hartojnë projekte kërkimore sasiore, cilësore dhe/ose të përziera për të adresuar këto hipoteza brenda kontekstit të shkencave sociale
4	Studentët e perceptojnë kornizën teorike
5	6. Studentët përdorin bibliotekat dhe burimet elektronike për të gjetur materiale të përshtatshme dhe janë në gjendje t'i vlerësojnë ato në mënyrë kritike
6	Studentët perceptojnë sfidat logjistike dhe etike si dhe strategjitë për tejkalimin e këtyre sfidave.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	12	12
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00